



GJENEZA - është faktori më kryesor që ndikon në prishjen e dhëmbëve në të njëjtën familje është e atakuar më tepër nga kariesi ka mundësi që edhe antarët pasardhës të trashëgojnë një të njëjtë mundje.

GJINIA - në bazë të të dhënave nga shoqata e stomatologëve, dhëmbët e gjinia femërore janë më të atakuar se tek meshkujt. Mendohet se arsyeja kryesore është në ndryshimet hormonale.

MOSHA - prishja e dhëmbëve është më shumë sëmundje e të rinjve, ajo tek më të moshuarit zvogëlohet, që nënkupton se tek të moshuarit më pak është e pranishme. Mosha prej 12-20 vjeçe konsiderohet si periudhë me më shumë karies ku gjatë kësaj periudhe prishen më tepër dhëmbët, por dhe në shumicën e rasteve ndodhë edhe të nxirret dhëmbi.

RACA - hulumtimet tregojnë proporcionalitet në mes racave ku edhe pse raca e bardhë ka përqindje të dhëmbëve me të atakuar nga ajo e zezë, prap se prap vlerat janë gati se të përafërta.

HORMONET DHE VITAMINET - çdo çrregullim hormonal i manifestuar në formë të hiperfungsionit apo hipofungsionit të hipofizës, tiroidës, paratiroidë shkakton paraqitjen e kariesit me përqindje të madhe. Hipofunksioni i paratiroidës shkakton hipokalcemin ndërsa hipovitaminoza e vitaminave A,D dhe C sjell gjer në prishjen e dhëmbëve.

KLIMA - varësisht nga hapësira gjeografike edhe paraqitja e kariesit ndryshon. Në vendet me klimë subtropikale përrreth ekuadorit, ka më pak karies por më tepër paradontopati në krahasim me vendet me klimë kontinentale. Po ashtu në vendet ku ndotja e ambientit është më e madhe, jonizimet e ndryshme dhe faktorë të tjerë janë shkaktar indirekt të rritjes së prevalencës së kariesit.

SËMUNDJET KRONIKE - të sëmurit që lëngojnë nga sëmundjet kronike kanë një prevalencë më të madhe të kariesit. Tek të sëmurit prej infarctus miocardi, diabetes mellitus, ulcus duadeni si dhe medikamentet që këto konsumojnë për shërimin e të njëjtave sëmundjeve nga ana tjetër ndikojnë dhe kanë efekte negative poashtu edhe tek dhëmbët.

USHQIMI - marrja e ushqimit të pasur me proteina, lipide, hidrate të karbonit, minerale, vitamine

si dhe oligoelementet ndikojnë në zhvillimin adekuat të aparatit dental. Po ashtu uji i pijshëm, që është i fluorizuar në mënyrë indirekte bën mbrojtjen e dhëmbëve prej kariesit.

Dr.stom Flamur Havziu